

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: 1.A.Sh. nga fshati D. e P., KK. P., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprat penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, 2.Xh.O. nga fshati D. e U., KK. P., për shkak të dy veprave penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së, 3.Xh.Z. nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, 4.Y.B. nga fshati L., KK. P., për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së dhe 5.H.P. nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, si dhe ndaj të miturit K. Z. nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së, sipas Aktakuzave PP.nr.2890-14/2006 të datës 13.11.2006 dhe PP.nr.3527-12/2007 të datës 29.12.2008, si dhe Propozimit për shqiptimin e masës edukuese - Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë ndaj të miturit, PPM.nr.354-12/2007, të datës 29.12.2008, të PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik me datë 12.01.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatmir Behrami dhe të akuzuarit A.Sh., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 19.01.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

1.A. SH., nga i ati E. dhe nëna R., e vajzërisë B., i lindur më *data e lindjes...*, nga fshati D. e P., Komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion IT, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra të njëjta penale, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera për vepra të njëjta penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me dt.01.09.2006, rreth orës 02:50, pas mes nate në fshatin D. KK. Podujevë në shtëpinë e të dëmtuarit B.Sh., i pandehuri më parë duke përdorur forcën me mjet të përshtatshëm ka hapur dritaren e podrumit të shtëpisë ka hyrë brenda dhe nga brendia ka marrë një palë puma një aparat fotografues, 115€ para të gatshme, me një vlerë të përgjithshme në shumë prej 615€.

II. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huajta të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri më dt.31.08.2007, rreth orës 04:00, në fshatin D. e P.,

ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit R. Sh. dhe me përdorimin e forcës, me mjet të përshtatshëm të pidentifikuar, ka hapur dritaren e kuzhinës, ka depërtuar brenda, ka shkuar në bodrum dhe nga aty ka vjedhur një gjenerator prodhim kinez dhe një shpuese (burmasinë) me bateri akumuluese që të dyja në vlerë rreth 600 €, dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

III. Me qëllim që me përvetësimin sendeve të huajta të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në intervalin kohor prej 28-30.08.2007, në orët e natës, në fshatin D. e P., ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit B. Sh. dhe me përdorimin e forcës, me mjet të përshtatshëm të pidentifikuar ka hapur dritaren e garazhës, ka depërtuar brenda dhe nga aty ka vjedhur një sharrë motorike për prerjen e druve të markës "Dolmar" në vlerë rreth 300€ dhe është larguar nga vendi i ngjarjes,-

IV. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huajta të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në intervalin kohor prej 28-30.08.2007, në orët e natës, në fshatin D. e P., ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit S. Sh. dhe me kalimin e pengesave duke hyrë fillimisht në katin e parë e pastaj ka shkuar në katin e dytë dhe në një dhomë në vitrinë – dollap nga një çantë femrash – të të dëmtuarës Sh. Sh. i ka vjedhur 40 € para të gatshme, dy unaza dhe dy pllaka të arit si dhe një "CD-player" me CD, që të gjitha në vlerë rreth 100€ dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

-me këtë në vazhdimësi ka kryer veprat penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 3, 11, 15, 34, 36, 38, 60, 64, 82, 83 dhe 253 par. 1 pika 1 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463 të KPPPK-së, e

G J Y K O N

Të akuzuarin **A. (E.) Sh.**, me **dënim me burg** në kohëzgjatje **prej 7 (shtatë) muaj**, dënim ky të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **100€ (njëqind/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që të t'ia kompensoi të dëmtuarës F. (H.) N. nga fshati D. e P., KK. P., shumën e të hollave prej 115€ (njëqind e pesëmbëdhjetë / euro), pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të dëmtuarit: B. (R.) Sh., R. (H.) Sh., B. (F.) Sh. dhe S. Sh., që të gjithë nga fshati D. e P., KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil, ndërsa e dëmtuara Sh. (S.) Sh. nga fshati D. e P., KK. Podujevë, në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se nuk parashtrohet kërkesë pasurore juridike.

Konform nenit 60 të KPK-së, nga i akuzuari konfiskohet një brisk flutur i modelit Stainless, i evidentuar sipas listës së provave materiale të policisë me numër të rastit 06-AF-2006 të dt.04.09.2006, si dhe Urdhërohet Policia që të njëjtin ta asgjësoj.

Ndërsa ndaj të akuzuarve dhe të miturit:

2.XH. O., me nofkën P., i biri i B. dhe nënës Z., e vajzërisë H., i lindur më *data e lindjes...*, nga fshati D. e U., KK. P., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

3.XH. Z., i biri A. dhe nënës M., e vajzërisë T., i lindur me *data e lindjes...*, nga P. rruga “...” pn, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

4.Y. B., i biri i V. dhe nënës F., e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...*, nga fshati L., KK. P., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

5.H. P., i biri Sh. dhe nënës B., e vajzërisë S., i lindur më *data e lindjes...*, nga P., rr. “...” pn, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

I mituri K. Z., i biri A. dhe nënës Sh., e vajzërisë H., i lindur me *data e lindjes...*, nga P. rruga “...” pn, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së,

REFUZOHET AKUZA dhe PROPOZIMI për shqiptimin e masës edukuese - Mbikëqyrja e shtuar nga ana e Organit të Kujdestarisë ndaj të miturit

Sepse,

I akuzuari Xh. O.:

1.Me datë të pacaktuar, në fillim të muajit shtator të vitit 2007, rreth orës 12:00, në Podujevë, i pandehuri ka dhënë ndihmë pas kryerjes së veprave penale të pandehurit A.Sh., në atë mënyrë që pasi është njoftuar nga A.Sh. se i ka disa stoli të arit për ti shitur e të cilat i kishte vjedhur, i pandehuri Xh. i ka marrë ato stoli dhe i ka shitur në një argjendari afër lumit “Llap” në vlerë prej 80€ dhe paratë i kanë ndarë,-

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së.

2.Me datë të pacaktuar, në fillim të muajit shtator të vitit 2007, rreth orës 11:00, në Podujevë, i pandehuri i ka dhënë ndihmë pas kryerjes së veprave penale të pandehurit A. Sh., në atë mënyrë që prej tij e kishte marrë një shpuese (burmashinë) me bateri akumuluese e cila ishte vjedhur she të njëjtën ia kishte shitur të pandehurit H. P. në shumë prej 20€,-

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së.

I akuzuari Xh. Z.:

Me datë të pacaktuar, në fillim të muajit shtator 2007, rreth orës 12:00, në Podujevë, i pandehuri nga i mituri K. Z. ka blerë një gjenerator të rrymës dhe një shpuese (burmashinë) me bateri akumuluese në vlerë prej 60€, edhe pse e ka ditur se ato sende janë përfituar në kryerjen e veprës penale,-

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

I akuzuari Y. B.:

Me datë të pacaktuar, në fillim të muajit shtator të vitit 2007, rreth orës 22:00, në rrugën e fshatit D., i pandehuri nga personat A.Sh. dhe Xh.O.e ka blerë një sharrë motorike të markës “Dolmar” në vlerë prej 65€, edhe pse e ka ditur se ai send është përfituar me kryerjen e veprës penale,-

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së.

I akuzuari H. P.:

Me datë të pacaktuar, në gjysmën e dytë të muajit gusht të vitit 2007, rreth orës 12:00, në Podujevë, në lokalin e tij nga personi Xh.O.– “P.”, ka blerë një shpuese (burmashinë) me bateri akumuluese, në vlerë prej 20€, edhe pse duke pasur parasysh çmimin e blerjes ai mund të ketë ditur se ai send është përfituar me kryerjen e veprës penale,-

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së.

I mituri K. Z.:

Më datë të pacaktuar në fillim të muajit shtator të vitit 2007, në Podujevë, i mituri i ka dhënë ndihmë pas kryerjes së veprës penale të pandehurit A. Sh., në atë mënyrë që pasi është njoftuar nga A.Sh. se e ka një gjenerator dhe një shpuese (burmashinë) për ti shitur e të cilat ai i ka vjedhur, i mituri këto sende i ka ofruar dhe shitur në shumë prej 60€, të pandehurit Xh. Z.,-

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së.

Akuza ndaj të akuzuarve Xh.O., Y.B. dhe H. P., si dhe Propozimi për shqiptimin e masës edukuese ndaj të miturit K. Z., refuzohen në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale për veprat penale për të cilat akuzohen, ndërsa ndaj të akuzuarit Xh.Z. në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së, sepse procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë, në kuptim të nenit 90 par.1 nënpar.6 dhe 91 par.6 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale sa u përket të akuzuarve Xh. O., Xh. Z., Y.B.dhe H. P., si dhe të miturit K. Z., bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.2890-14/2006, të datës 13.11.2006, kundër të akuzuarit A.Sh. nga fshati D. e U., KK P., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, pastaj Aktakuzën dhe Propozimin për shqiptimin e masës edukuese - Mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë PP.nr.3527-12/2007 dhe PPM.nr.354-12/2007, të datës 29.12.2008, kundër të akuzuarve: 1.A.Sh. nga fshati D. e P., KK. P., për shkak të tri veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, 2.Xh.O.nga fshati D.e U., KK. P., për shkak të dy veprave penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së, 3.Xh.Z.nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, 4.Y.B.nga fshati L., KK. P., për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së

dhe 5.H.P.nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, si dhe ndaj të miturit K. Z. nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këto çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.01.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatmir Behrami dhe të akuzuarit A. Sh., në të cilën me pajtimin e palëve, bazuar në nenin 35 par.8 të KPPRK-së, si dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit, mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të akuzuarit A.Sh. për lëndët PKa.nr.6/2009 sipas aktakuzës PP.nr.3527-12/2007, të datës 29.12.2008 dhe P.nr.528/2006 sipas aktakuzës PP.nr.2890-14/2006, të datës 13.11.2006, ashtu që çështja penale për këto dy lëndë do të bartë numrin më të vjetër P.nr.528/2006, ndërsa lidhur me të akuzuarit Xh. O., Y. B., H.P., si dhe të miturit K. Z., me aktvendim e hodhi pjesërisht aktakuzën PP.nr.3527-12/2007 dhe në tërësi Propozimin për shqiptimin e masës edukuese ndaj të miturit PPM.nr.354-12/2007, sa u përket këtyre, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ashtu që vazhdoi me shqyrtimin fillestar vetëm sa i përket të akuzuarit A. Sh..

Pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari A.Sh. deklaroi: e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzave, e ndjej veten të fajshëm, pendohem dhe ndjej keqardhje për këto veprime që u janë shkaktuar të dëmtuarve, nga viti 2009 nuk kam kryer vepra tjera penale, jam familjar dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: pasi janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, i akuzuari është në dijeni për pranimin e fajësisë dhe me vullnetin e tij të lirë i pranoi dhe akuzat me të gjitha pikat të cilat i vihen në barrë, i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merret si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjeve që i përmbajnë aktakuzat në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe se aktakuzat nuk përmbajnë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së, pasi që janë kryer më shumë se dy vepra penale, janë të llojit të njëjtë, i ka kryer i njëjti person të gjitha veprat penale, të gjitha veprat penale janë kryer brenda periudhës së shkurtë kohore dhe të gjitha këto vepra penale janë kryer me dashje.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit A.Sh. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në vazhdimësi vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, e për çka gjykata

gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata lidhur me të akuzuarit Xh.O. nga fshati D. e U., KK. P., për shkak të dy veprave penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së, Xh.Z. nga P., rr. "...” pn, për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, Y.B. nga fshati L., KK. P., për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së dhe H.P. nga P., rr. "...” pn, për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.2 të KPK-së, si dhe ndaj të miturit K. Z. nga P., rr. "...” pn, për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 305 par.1 të KPK-së, në seancën e datës 12.01.2016 me aktvendim ka konstatuar se ka arritur parashkrim absolut i ndjekjes penale për këto vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një vit, përkatësisht dënimi me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj, në kuptim të nenit 90 par.1 nënpar.6 KPK-së, ligjvënësi ka përcaktuar se parashkrimi i ndjekës penale është dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vit burgim ose dënim me gjobë, ndërsa neni 91 par.6 të KPK-së, ka paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), meqenëse nga gjysma e dytë e muajt gusht dhe fillimi i muajit shtator të vitit 2007, e deri me marrjen e vendimit kanë kaluar më tepër se tetë vite, ashtu që parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këto vepra penale ka arritur në muajin shtator të vitit 2011, prandaj gjykata vendosi me aktgjykim refuzues në bazë të nenit 363 par.1 pika1.3 të KPPRK-së, përkatësisht për të akuzuarin Xh.Z. vendosi në bazë të nenit 363 par.1 pika1.2 të KPPRK-së, pasi që gjykata pas kërkesës së të njëjtit e ka pushuar procedurën kundër tij sipas aktvendimit të formës së prerë me numër PKa.nr.6/09, të datës 16.01.2013, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit lidhur me të akuzuarin A. Sh., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe se ishte korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra penale të njëjta, sipas aktgjykimeve: P.nr.527/2006 i formës së prerë me dt.04.10.2013, P.nr.599/2006 i formës së prerë me dt.18.10.2011, P.nr.1598/2007 i formës së prerë me dt.31.05.2013, P.nr.1901/2007 i formës së prerë me dt.02.04.2009, PKa.nr.4/2010 i formës së prerë me dt.23.12.2014, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është prona private, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbaj pasi aktgjykim të merr formën e prerë.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 34 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket të akuzuarit A.Sh. është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa sa u përket të akuzuarve tjerë dhe të miturit është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi detyrimin e të akuzuarit A.Sh. që t'ia kompensoi të dëmtuarës F. N. shumën e të hollave është marrë në kuptim të neneve 82 dhe 83 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e briskut-flutur nga i akuzuari A. Sh., është marrë në kuptim të nenit 60 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 365 dhe 363 par.1 pika 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.528/2006,dt.19.01.2016

Sekretarja Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.